



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2025:034908
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06893653

C-IV-14-2654

Ankuesi

Rr Sh, Gjilan.

Përfaqësuar nga avokati Sh Xh, Gjilan.

Kundër

E paditura

NSH “Industria e Duhanit” të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrije Shala, më datë 19.02.2025 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. GJI003-0583/0180, i datës 10 mars 2014.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit Rr Sh në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën gusht 2003-maj 2004, t’i paguaj shumën prej 1.445.50 € dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj shumën prej 144.50€
- 3.** Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 4. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 €.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11 prill 2014, përfaqësuesi i ankuesit dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një kërkesë/ankesë kundër Vendimit nr. GJI003-0583/0180, i datës 10 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për pagat e papaguara, në shumë prej 1.445.50€, për periudhën gusht 2003 – maj 2004, nga NSH “Industria e Duhanit” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se pas luftës ka punuar në ish ndërmarrjen shoqërore Industria e Duhanit në Gjilan, mirëpo, të njëjtit NSH nuk ia ka paguar të ardhurat personale prej muajit gusht të vitit 2003 e deri me 20 maj 2004. Po ashtu, ankuesi pohoi se me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të gjithë punëtorëve, me shkresën e datës 15 gusht 2006 ishin njoftuar se shumë-pagat që u janë borxh sipas kontratës të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit, si dhe do të kontaktohen kur të fillojnë këto procedura. Më tej ankuesi pohoi se pas fillimit të likuidimit të NSH-së, AKM-ja e atëhershme përmes mjeteve të informimit i kishte ftuar të gjithë personat se lidhur me çfarëdo kërkesë duhet ti drejtohen këtij institucioni për realizimin e të drejtave të tyre. Tutje ankuesi pohoi se kishte vepruar sipas këtij njoftimi dhe kishte dorëzuar të gjithë dokumentacionin, regjistrin si dhe formularët e kërkesës për likuidim. Më tej ankuesi pohoi se vendimet e të paditurës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që në shkresën e datës 15 gusht 2006 thuhet se ato kërkesa duhet ti drejtohen Agjencionit, kurse në vendimet e kundërshtuara thuhet se ato kërkesa është dashur ti drejtohen gjykatës. Ankuesi propozoi që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe ti njihet e drejta në kompensim për paga të papaguara në shumë prej 1,445.50 €, me kamatë ligjore si dhe ti njihen shpenzimet e procedurës. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar dokumentet si: autorizimin për përfaqësim të vërtetuar tek noteri, vendimin e kundërshtuar, kopjen e listës së pagave të llogaritura për punëtorët të pa paguara për muajin gusht 2003 deri me 20 maj 2004, kopjen e njoftimit të datës 15 gusht 2006 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kopjen e kërkesës se AKP drejtuar kryetarit të Gjykatës Komonale në Gjilan të datës 06 maj 2008, dhe kopjen e aktvendimit C.nr. 165/07 të datës 21 maj 2008, të lëshuar nga Gjykata Komonale në Gjilan.

Me 26 janar 2017, e paditura parashtrori përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Më tej e paditura pohoi se nuk ka prova që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit, pra tri vite nga gushti i vitit 2003. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar. Kësaj mbrojtje i ka bashkangjitur: Vendimin e AL-së me nr. GJI003-0583/0180, i datës 10 mars 2014.

Më datë 16 shkurt 2017, përfaqësuesi i ankuesit është përgjigjur në mbrojtjen- përgjigjen e dhënë nga ana e AKP-së, duke shtuar se procedura e likuidimit të NSH-së ka filluar me datë 04

korrik 2007 dhe se njoftimet për këtë janë bërë përmes mjeteve të informimit dhe se kërkesa e ankuesit gjënë mbështetje në dispozitat e nenit 7 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 si dhe në Rregulloren e UNMIK-ut me numër 2002/12, po ashtu ka theksuar se palët me njoftimin e datës 15 gusht 2006 janë njoftuar për ndërprerjen e marrdhënjës së punës si dhe për faktin se të drejtat e tyre për kompensim do ti realizojnë pas fillimit të procedurës së likuidimit duke shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, duke kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesa e ankuesit.

Me datë 16 mars 2017 AKP ka ushtruar kundërpërgjigje duke theksuar se e kundërshton si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e detyrimit të pretenduar duke shtuar se parashtruesi e ka detyrimin për përmbushjen e provave dhe se një detyrim të tillë i njëjti nuk e ka përmbushur.

Gjykata me datë 14 shkurt 2022 kishte marr Aktvendim me të cilin e kishte konsideruar të tërhequr ankesën e ankuesit për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore, ndaj të cilit vendim përfaqësuesi i ankuesit kishte paraqitur ankesë dhe propozim për kthim në gjendjen e mëparme duke deponuar edhe provën mbi pagesën e taksës gjyqësore, me që rast gjykata me vendimin e datës 20 dhjetor 2024, ka aprovuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparme.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa dispozita e nenit 42.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen aktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”*. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Industria e Duhanit” në Gjilan. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara si dhe lartësia e shumës së kërkesës. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi e kundërshton një pretendim të tillë duke u bazuar në njoftimin e datës 15 gusht 2006, pastaj në listën për pagat e papaguara për muajt gusht 2003-maj 2004, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. E paditura nuk e ka kundërshtuar bazën dhe lartësinë e kërkesës së ankuesit. Në një çështje civile një fakt i pretenduar nga njëra palë në kontest nëse nuk kontestohet gjatë procesit kontestimor, konsiderohet si fakt i vërtetuar dhe mbi atë fakt mund të bazohet vendimi gjyqësor.

Megjithatë nga lista për pagat e punëtorëve të pa paguara, vërtetohet fakti se ankuesi kishte paga të papaguara nga NSH në shumë prej 1,445.50 €. Andaj, gjykata e pranon si provë relevante dhe të bazuar listën për pagat e punëtorëve të pa paguara, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën gusht 2003 – maj 2004 dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën për pagat e papaguara.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL me 21 shtator 2007. Gjykata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 15 gusht 2006 dhe kësioj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se letra e datës 15 gusht 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësioj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe njohjes së pagave të papaguara, andaj si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 15 gusht 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrorë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i

ankuesit, kësisoj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashkrimit të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësisoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168, AC-I-20-0183 etj).

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vjen në përfundim se ankuesi Rr Sh, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 144.55 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Sa i përket parashkrimit të kërkesës të cilën pala e paditur e ka arsyetuar, gjykata e vlerësoi pa e marr si pretendim kryesor, për faktin se çështja e parashkrimit është institut i veçant me afate të përcaktuara me ligj e të cilat nuk do të ishte fare e vështirë të përcaktohet pasi që njoftimi mbi ndërprerje të mardhënjes së punës veq e kishte ndërprerë parashkrimin. Por, në këtë rast gjykata u mbështet në provat e prezentuara nga ankuesi, të cilat nuk ishin të mjaftueshme për t'ia aprovuar kërkesën për pagat e papaguara .

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura është obliguar ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 €, në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve, në shumat prej: 104.00 € për ankesë dhe 20 € për taksën gjyqësore.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrihet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare

Hajrije Shala